

REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Drejtësisë / Ministarstvo Pravde / Ministry of Justice
 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
 Agencija za Upravljanje Zapoljenjima i Konfiskovane Imovine
 Agency for the Management of Sequestered or Confiscated Assets

Nr. Prof. Bc. Prof. Prot. No: 560
 Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 02
 Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 01
 Data Datum Date: 20.07.2023
 PRISHTINË/A



AAPS

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 AKADEMIJA E DREJTËSISË
 AKADEMIJA PR AVUDI - ACADEMY OF JUSTICE

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 1
 Nr. Prof. Bc. Prof. Prot. No: 341
 Nr. Faqeve Broj Stranica No. Pages: 03
 Data Datum Date: 12.07.2023
 Prishtinë / a



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

AKADEMISË SË DREJTËSISË

dhe

**AGJENCISË PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR
 OSE TË KONFISKUAR / MD**

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është përgatitur me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi qe janë në interes të përbashkët.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Palët e lartcekura do të bashkërendojnë aktivitetet për avancimin e administrimit të pasurive të sekuestruara përmes:

- Mbështetjes profesionale, teknike dhe organizative në ofrimin e aktiviteteve të ndryshme lokale, rajonale dhe internacionale që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të krijuara në mënyrë të kundërligjshme si dhe administrimin e tyre për zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi si dhe
- Realizimin e aktiviteteve tjera me interes të përbashkët në këtë fushë.

Neni 3

Obligimet e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

- Të bashkëpunojë dhe shkëmbej informata verbale ose me shkrim për punën dhe funksionimin e agjencisë konform legjislacionit përkatës;
- Të bashkëpunojë dhe shkëmbej informata verbale ose me shkrim për qëllimet e trajnimeve që do të planifikohen lidhur me administrimin e pasurive të cilat janë nën administrimin e Agjencisë.

Neni 4
Obligimet e Akademisë së Drejtësisë

- Të mundësoj pjesëmarrjen e personelit të Agjencisë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë që kanë në fokus të veçantë administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të sekuestruar dhe të konfiskuar;
- Të bashkëpunoj me Agjencinë për përmbajtjen e programit trajnues për sekuestrimin dhe konfiskimin dhe të merre në konsideratë edhe nevojën e personelit të Agjencisë e cila bënë administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Neni 5
Organizimi i aktiviteteve

Të gjitha aktivitetet e lartë përmendura do të organizohen në bazë të fondeve buxhetore të disponueshme për secilin institucion.

Neni 6
Dispozitat përfundimtare

Bashkëpunimi bazohet vetëm në marrëveshjen e cila synon ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Të dy institucionet do të emërojnë nga një pikë kontakti, përgjegjës për komunikim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta dhe ta informojnë njëra tjetrën në formë të shkruar.

Neni 7
Kohëzgjatja dhe Përfundimi

Secila palë mund ta zgjidh këtë Marrëveshjen në tërësi apo pjesërisht me anë të njoftimit me shkrim palës tjetër së paku një muaj më parë.

Secila palë mund ta zgjidhe këtë Marrëveshje në tërësi apo pjesërisht në rast të ndonjë shkelje nga Pala tjetër duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim për përfundimin e Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshoj vetëm me shkrim dhe me nënshkrim të Përfaqësuesve të Autorizuar si më poshtë.

Neni 8
Gjuha e përdorur

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit është përgatitur nga 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe serbe. Për secilën palë nga një kopje në të dy gjuhët.

Neni 9
Pëlqimi i palëve

Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të Marrëveshjes.

Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptimin e palëve.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe do të vazhdojë deri sa palët nuk e zgjidhin atë.

Për Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara


Enver Krasniqi

Zv. Drejtor i Përgjithshëm i AAPSK-së

Për Akademinë e Drejtësisë


Enver Fejzullahu

Drejtor Ekzekutiv i AD-së

Nënshkruar me 12.07 2023, Prishtinë